

20140441307

LIGJ PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 20/2004, 115/2007, 18/11, 148/11, 23/13, 137/13 dhe 164/13), pas nenin 144 shtohet titull i ri dhe nen i ri 144-a, si vijon:

“Udhëheqja me Drejtorinë

Neni 144-a

- (1) Me punën e Drejtorisë udhëheq drejtori.
- (2) Drejtorin e Drejtorisë e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.
- (3) Drejtori i Drejtorisë ka mandat prej katër viteve dhe përsëri mund të emërohet vetëm edhe një mandat.
- (4) Për drejtor të Drejtorisë mund të emërohet personi i cili i plotëson këto kushte:
 - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
 - ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose ka mbaruar shkallën VII/,
 - të ketë minimum pesë vite përvojë pune, prej të cilave tre vite në fushën e trashëgimisë kulturore,
 - të posedojë njërën nga certifikatat apo dëshmitë vijuese të njohura ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
 - IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
 - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
 - FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë,
 - BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë ose
 - APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2) dhe
 - të ketë kaluar testin psikologjik dhe testin për integritet.”

Neni 2

Drejtori i Drejtorisë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, i emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdon ta kryejë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është emëruar.

Neni 3

Dispozitat nga neni 1 i këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me kushtin për njohje të gjuhës së huaj, do të fillojnë të zbatohen pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, kurse do të fillojë të zbatohet pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.